

Katër gjenerata shfrytëzues bursash nga programi i bursave Boris Trajkovski -Nova


Fillet e programit janë nga viti 2005 dhe në të janë paraqitur katër gjenerata të suksesshme të diplomuarit të cilët vazhduan arsimimin e tyre në universitetet më të mira amerikane dhe evropiane. Këtu janë deklaratat e maturantëve të fundit:



Marrja e bursës nga një program bursash Boris Trajkovski - NOVA ishte vendimtare për rritjen time akademike dhe zhvillimin. Nova më ka ndryshuar mua dhe formuar në shumë mënyra. Gjatë arsimimit të mesëm, fitova njohuri dhe aftësi që më lejuan regjistrimin në universitete prestigjioze në SHBA dhe Evropë. Mësoja në mjedis të "vërtetë" multikulturor me çka dhe u formova në një qytetar i botës me mendje kritike dhe të hapur. Si shpërblim me dinjitet e përfaqësova Nova-n dhe fondacionin në garat e shumta dhe ne ngjarjet. Sot studioj në Universitetin e Harvardit, ku kam mundësi për të marrë pjesë në leksionet e profesorëve më të mirë në botë dhe të merrem me punë kërkimore e shkencore në laboratorët më të pajisura në botë.
Ana Kotevska



Nova më ndihmoi të zhvillohem si në rrafshin intelektual poashtu dhe në atë emocional, duke me përgatitur kështu me sfidat me të cilat përballem tani si student në Universitetin Jeil në SHBA. Zgjedhja e programeve studimore në sferën e arteve dramatike dhe letërsisë në përputhje me aspiratat e mia dhe njohuritë e fituara në shkollën e mëparshme të arsimit tim të mesëm. Kur kam aplikuar për bursë Boris Trajkovski, unë nuk e dija se në çfarë lëshohem, veç se kisha ambicie të kem sukses - tani e di se me marrjen e kësaj burse më është dhënë drejtimi që unë e pata të nevojshëm që me sukses të vazhdoj shkollimin tim në një nga universitetet më prestigjioze të botës.
Aleksandra Gjorgievska



Kam ardhur në Nova nga Tetova, përmes bursave të programit Boris Trajkovski-NOVA. Katër vite të kaluara në Nova ishin për mua një përvojë e paharrueshme, si në aspektin e mësimin akademik dhe në procesin e pjekjes personale. Mundësia që vetë të përpiloj programin duke përzgjedhur lëndët dhe nivelet e duhura në të mësuarit e tyre, me ka ndihmuar mua të merrem më thellë në studimin e ekonomisë dhe financave, të cilat me të vërtetë me përgatiten mua për studime në të njëjtin program në Universitetin e Evropës Juglindore. Besoj se një ditë, nëpërmjet shembullit tim personal, do të kem mundësi tua kthej besimin që më ishte dhënë nga udhëheqësia e gjimnazit Nova dhe fondacionit Boris Trajkovski.
Artina Bexheti

Programi i Bursave Boris Trajkovski-Nova 2012



Katër gjenerata të reja shfrytëzues të bursave

Presidenti i ndjerë Boris Trajkovski ishte mik i NOVA-s.

Disa aspekte të trashëgimisë së tij të projektimit, të cilat në thelb përputhen me misionin dhe filozofinë e funksionimit të shkollës janë baza mbi të cilën bazohet një partneritet në mes NOVA dhe Fondacionit Boris Trajkovski.

Nëpërmjet programit të bursave, të dy institucionet marrin pjesë në mbështetje të nxënësve veçanërisht të talentuar dhe udhëheqësve të ardhshëm të bashkësisë maqedonase.

Numri dhe vlera e bursave

Do të jepen tre bursa të plota. Përveç kësaj, dhjetë studentë nga 20 më të lartë të pozicionuar, do të lejohen të aplikojnë për ndihmë financiare e cila mund të mbulojë deri në 50% të pagesës së shkollimit.

Fitimi i sërishëm i bursës

Bursat automatikisht rifitohen për çdo vit me kusht që student i shfrytëzues i bursës duhet që të përmbushë pritjet akademike dhe udhëheqëse të shkollës: të arrij sukses të vazhdueshëm të lartë, dmth me një mesatare prej 10 ose më shumë nota nga 1 deri në 12, të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në ndihmën e programit për bashkësi si dhe për të marrë pjesë aktive në të paktën në një nga programet për udhëheqje të shkollës. Çdo incident i pandershmërisë akademike, apo shkelje të rëndë disiplinore do të tërheqë ndërprerjen e programit të bursave.

Kriteret për përzgjedhjen

- Aplikimi për bursë me rekomandimet
- Suksesi i shkëlqyeshëm i kasave V-VIII
- Rezultatet e testeve në * anglisht dhe Matematikë * ¹
- Ese * në anglisht
- Intervistë në anglisht

Rezultatet totale të vlerësimit të esesë dhe testet e gjuhës angleze si dhe matematikë do të publikohen. Njëzet (20) Kandidatët më të mirë do të thirren ti nënshtrohen intervistës para Komisionit. Kur zgjidhen tre (3) shfrytëzues bursash të plota, në rast të pikëve të barabarta mes tyre, në këtë rast sholla e merr të drejtë vendimi. Kandidatët e renditur sipas numrit rendor 4 gjer në nr 20 kanë të drejtë të aplikojnë për ndihmë financiare*². Do të zgjidhen më së shumti 10 kandidatë nga numri i përgjithshëm i aplikantëve. Vlera e ndihmesës së dhënë financiare mbulon deri në 50% të shpenzimeve për shkollim.

¹ Te gjitha testimet do të realizohen nën kod si dhe rezultatet totale (lista përfundimtare) do të publikohen me kod.

² Kandidatet të cilët aplikojnë për ndihmë financiare duhet të dorëzojnë formular shtesë për ndihmë financiare.

Afati për regjistrim

27 shkurt - 15 mars 2012

Dokumentet për aplikim:

(1) Formulari (Ofrohet dhe për ta zbritur nga rrjeti) që mund ta merrni në Nova International School ose webfaqen e NOVA simbolit www.nova.edu.mk) në formatin PDF

(2) Rekomandimet:

- Nga kujdestari i klasës
- Mësuesi i zgjedhur nga studenti

(3) Fotokopje e dëftësive të klasave 5.6 dhe 7-të; foto-kopje nga vlerësimet gjysmë-vjetore të klasës së 8-të

(4) Fotokopje e certifikatave / çmime të marra në gara (jo certifikatat ose vërtetimet e kurseve të përfunduara dhe programeve tek të cilat keni marrë pjesë)

(5) Fotokopje e certifikatës së lindjes dhe një foto me format pasaporte

Procedura:

- **27 shkurt - 15 mars 2012, nga ora 8:00 me 16:00**

Në 6 mars (e martë) nga ora 17:00 deri në 18:30 në ambientet e Nova – gjimnazit takim informativ për të gjithë studentët dhe prindërit të interesuar.

- **17 mars 2012 (e shtunë) në orën 10:00**

Testimi nga gjuha angleze dhe matematikë dhe përpilimi i eseut mbi një temë të caktuar. Kohëzgjatja e testit: 4 orë përfshirë një pushim prej 30 minutash

- **19 mars - 23 mars**

Shqyrtimi i kërkesave të paraqitura, vlerësim i testeve dhe përzgjedhja e njëzet (20) kandidatëve më të mirë.

- **23 Mars, 13:00**

Publikimi i rezultateve (sipas kodit) në tabelën e shpalljeve në NOVA dhe webfaqen e internetit të shkollës.

- **26 mars për 30 mars**

➤ Intervista individuale me njëzet (20) kandidatët e përzgjedhur para Komisionit

- **6 prill**

Informimi i fituesve të bursave me postë. Çdo student i zgjedhur është i obliguar për të konfirmuar regjistrimin në Nova në afat brenda një jave, përndryshe bursa do të ofrohet kandidat alternativ.